



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1138/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social Facebook, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa Anr.1138/2021 e datës 14.11.2021, e paraqitur nga Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale. Ndërsa subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 300.00 (treqind euro), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

II. DETYROHET Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje që gjobën e shqiptuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 14.11.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.1138/2021, të paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, kundër Berat Lahut, Fisnik Krasniqi dhe Valon Svirca asambleist në Komunën e Prishtinës dhe të Obiliqit, gjate datës 14.11.2021 përmes rretit social Facebook kan ber thirrje që të votohet Subjekti i tyre Politik me numër figurativ 144, me këto veprime kan ndikur tek qytetarët pasi që të njejtve u është bër presion për

mënyren e votimit. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Në përgjigjet në ankesë të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, theksohet se kjo ankesë është e pabazuar për faktin se ankuesi pretendimet e veta nuk ka mundur ti mbështes në prova konkrete pasi që postimi i pretenduar në ankese, nga asambleistet e këtij subjekti kanë postuar gjat ditës se votimit.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, asambleist të saj, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin social “Facebook” ka bërë fushatë zgjedhore ashtu që përmes rrjetit social “Facebook” kanë bërë një postim ku shihet thirrja e cila i behet votuesve për të votuar për Subjektin e tyre Politik me numër 144, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse postimi i asambleistëve të këtij Subjekti i bërë nga Berat Lahut, Fisnik Krasniqi dhe Valon Svirca, ishte i publikuar më datë 13.11.2021 gjatë heshtjes zgjedhore dhe i njëjti ishte ende prezent në faqen e përdoruesve nga vetë përdoruesit në fjalë në kohën e cekur si në ankese por edhe në kohën e hetimit të PZAP-it.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli mori faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar

gjoba ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka bërë përpjekje që të njoftoj kandidatët e saj lidhur me respektimin e legjislacionit në fuqi me qëllim të evitimit të shkeljeve gjatë heshtjes zgjedhore, e të cilat rrethana kanë ndikuar në lehtësimin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ *Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.*”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1138/2021 më datën 15.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.